

NJOFTIM
PËR MBLEDHJEN E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME
TË AKSIONERËVE TË "BANKA CREDINS" SH.A.

Për: Z/Znj. _____ (Aksioner/Perfaqesues/e i/e Aksionerit _____)

Ju njoftojmë se ditën e Enjte datë 28 Janar 2016, ora 14:00 në ambientet e "BANKA CREDINS" SH.A., në adresën Rr. "Ismail Qemali" Nr. 4, Tiranë, do të zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të "BANKA CREDINS" SH.A me rend dite si më poshtë:

1. Propozim për miratimin e ndryshimit në nenin 19.1 të Statutit të Bankes Credins sh.a si më poshtë:

Ishte: 19.1 Mbledhjet e Këshillit Drejtues do të mbahen **të paktën 6 herë në vit**, dhe do të konsiderohen të mbledhura rregullisht vetëm nëse mungon jo më tepër se një anëtar. Nëse një mbledhje, nuk është e mbledhur rregullisht për shkak të mungesës së kuorumit, kjo mbledhje do të shtyhet për një datë tjetër jo më pak se 2 ditë pune nga mbledhja e parë dhe në këtë rast mbledhja do të zhvillohet me praninë e më shumë se gjysmës së anëtarëve të Këshillit Drejtues.

Behet: 19.1 Mbledhjet e Këshillit Drejtues do të mbahen **të paktën 4 herë në vit**, dhe do të konsiderohen të mbledhura rregullisht vetëm nëse mungon jo më tepër se një anëtar. Nëse një mbledhje, nuk është e mbledhur rregullisht për shkak të mungesës së kuorumit, kjo mbledhje do të shtyhet për një datë tjetër jo më pak se 2 ditë pune nga mbledhja e parë dhe në këtë rast mbledhja do të zhvillohet me praninë e më shumë se gjysmës së anëtarëve të Këshillit Drejtues.

2. Propozim për dhënien e miratimit lidhur me përfaqësimin e Bankës Credins nga z.Maltin Korkuti në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme të Aksionarëve të Shoqërisë Administruese të Fondit të Pensionit SiCRED sh.a me datë 05.02.2016 me rend dite si më poshtë:

1. Mbi miratimin e strukturës aksionare të Shoqërisë Administruese të Fondit të Pensionit SiCRED sh.a..
2. Çështje të tjera parashikuara shprehimisht nga ligji.

Jeni të lutur të paraqiteni. Ju Faleminderit.

Maltin KORKUTI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Tirane me 07.01.2016

Sqarojmë se:

Referuar Statutit të shoqërisë dhe Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare» Aksionerët kanë këto të drejta dhe detyrime:

- Aksionarët, të cilët zotërojnë aksione, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë ose një përqindje më të vogël, të parashikuar në statut, mund t'u drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë komunikimin me postë elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose, jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë, të kërkojnë përfshirjen e çështjeve të caktuara në rend të ditës. Në kërkesë duhet të jepen arsyet dhe objektivat, si edhe çështjet për të cilat duhet të marrë vendime asambleja e përgjithshme. Nëse kërkesa nuk është pranuar, këta ortakë kanë të drejtë të thërrasin asamblenë e përgjithshme e të vendosin çështje në rendin e ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 137 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare»
- Nëse asambleja e përgjithshme, në kundërshtim me sa më sipër, nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk përfshihet në rendin e ditës, secili prej aksionarëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:
 - a) të ngrejë padi në gjykatë për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse organet drejtuese nuk përmbushin kërkesat e tyre brenda 15 ditëve;
 - b) t'i kërkojnë shoqërisë blerjen e aksioneve të zotëruara prej tyre, sipas nenit 133 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare».
- Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, dhe thirrja u është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, në të njëjtat mënyra, me të cilat është kryer njoftimi i parë.
- Një aksionar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një prokure nga një aksionar tjetër, apo nga një person i tretë.
- Administratorët dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.
- Prokura, mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të aksionarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të aksionarit përfaqësuar.
- Asambleja merr vendimet nëpërmjet votimit të hapur.
- Për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës apo administratorëve, asambleja e përgjithshme vendos me votim të fshehtë, nëse kjo mënyrë votimi kërkohet nga aksionarët, të cilët zotërojnë një numër aksionesh, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
- Kopje të dokumentave dhe projekt-vendimeve bashkëlidhur me këtë njoftim do të gjeni edhe pranë Selisë së shoqërisë, nëpërmjet një kërkesë me shkrim të depozituar pranë shoqërisë "Credins Bank" sh.a.